

STATUTI
TRADE CORP SHPK
SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 01/09/2021 (1 Shtator 2021), ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me Emrin Trade Corp Shpk dhe Emër tregtar **Trade Corp Shpk**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Z.Engjëll Dedja**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11/05/1984, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip kartë me Nr. Personal I40511063K, i lëshuar nga MPB në datën 12.05.2009.
- **Z.Besnik Bahiti**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 17/05/1979, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip kartë me Nr. Personal H90517146B, i lëshuar nga MPB në datën 09.04.2021.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- Projektim arkitektonik,interior design, projekte arkitektonike dhe inxhinierike për mobilim fasadash dhe interiorësh, punime në ambiente të ndryshme si dhe studim projektimi.
- Import, Eksport si dhe blerje me pakicë dhe shumicë të të gjitha llojeve të produkteve.
- Analizë dhe vlerësim të biznesit, i strukturave operative financiare për industri të ndryshme

financimeve të ndryshme, modelim i biznesit, këshillime mbi ristrukturimin e organizimit financiar, studime tregu, studime plan biznesi, transaksionet dhe strategjinë e shitjeve, këshillime mbi partnershipe të ndryshme, negocime të termave të marreveshjes, vleresime risku dhe këshillime për mitigimin e tyre.

Shërbime ligjore. Asistencë për leje, autorizime dhe licensime nga organet publike.

Ristrukturim të bizneseve në vështiresi, këshillime dhe asistencë në marrëdhëniet me institucionet financiare, këshillime dhe bashkëpunime me dhe për sektorin publik.

Vlerësim i pasurive të paluajtshme, studim, projektim dhe mbikqyrje e zbatimit të punimeve në ndërtim, ndërtime civile. Zbatimi i ndërtimit të objekteve të ndryshme, përfshirë ato civile, industriale si dhe në restaurime. Vlerësime mjedisore si dhe ndërmjetesim i aktiviteteve të projektimit, ndërtimit dhe supervizimit të objekteve me interes publik dhe privat. Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, veprave të artit dhe objekteve muzeale. Real estate, ndërmjetesim dhe shit- blerje pronash dhe marrje me qera, si dhe dhënie me qira të automjeteve si dhe shitje dhe dhënie me qira të materialeve, . Ofrimin e kurseve dhe trajnimeve profesionale në fusha të tilla si hoteleri turizem dhe hosting, teknologji informacioni dhe programin, zhvillim softwaresh , dhe mirëmbajtje rrjeti kompjuterik, blerje dhe shitje produktesh kompjuterike , fron- end developer, python, java. Ushtimin e aktivitetit për krijimin/përmirësimin/mirëmbajtjen e të dhënave gjeohapësinore. Prodhimi i energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit, operimit dhe transferimit të burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, të tilla si sistemet fotovoltaike, gjeneruesit me erë, burimet gjenerues të prodhimit të kombinuar të energjisë elektrike dhe nxehtësisë si dhe gjeneruesit me biomasë. Projekte fizibiliteti ne fusha të ndryshme , studime me impak social mjedisore, konsulence ekonomike, ligjore, inxhinierike, ne zhvillim dhe implementim projektesh me partner vendas dhe te huaj, vleresim trojesh dhe tokash bujqesores, shitje dhe marrje me qera tokash bujqesore, blerje me pakice dhe shumice artikujsh bujqesor, fara dhe fidane , projektim dhe ndërtim , kolaudim , digash, kanalesh ujites dhe vadites , basene , liqene dhe rezervuare , konsulence per sigurine personale, godinave etj , konsulence ne ndertim serash bujqësore , marketing bujqësor, projekte me bazë punësimin e të rinjve , mbrojtjen mjedisore, lumenjve, baseneve, liqeneve, dizefektim ambjentesh , rikonstruksione godinash, fushash sportive. Blerje dhe shitje me shumice dhe pakice artikujsh ushqimor, industrial, kozmetikë, blegtoral, inpute bujqësore, materialesh ndertimi, projektim – instalim, blerje dhe shitje sistemesh alarmi, kamera, gps etj!

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë vendoset për një periudhë të pacaktuar kohore nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB).

Neni 4:

Selia

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Lagjja Tiranë, Rruga Eduart Mano, Pallati Tocak, Apartamenti Nr 4.
- (2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

Kreu II

KAPITALI, KONTRIBUTET E KAPITAL THEMELTAR, SHËRNDARJA E KUOTAVE ETJ.

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme. Kontributi i kapitalit themeltar ka ndodhur si vijon:

Ortakët Themelues:

1. *Z. Engjëll Dedja* : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 Lekë (Pesëdhjetë mijë lekë) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. *Z. Besnik Bahiti* -Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 Lekë (Pesëdhjetë mijë lekë) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë

Ortakët kanë depozituar kapitalin themeltar prej 100,000 (Njëqind mijë) lekë në një llogari bankare.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e

ortakëve e një eksperti kontabël të regjistruar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat mund t'iu transferohen palëve të treta tërësisht ose pjesërisht nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin themeltar;
- b) Blerjes - shitjes së kuotave;
- c) Trashgimisë;
- d) Dhurimit;
- d) Çfarëdo mjeti tjetër të parashikuar nga ligji.

Në rastin e transferimit të ndonjë titulli të kuotave ndaj palëve të treta, ortakët e tjerë mund të preferohen në blerjen e kuotave në proporcion me kuotat e tyre në të njëjtin çmim dhe nën kushte të njëjta të ofruara nga pala e tretë.

Në këtë rast ortaku shitës duhet t'iu komunikojë ortakëve të tjerë çmimin e ofruar nga pala e tretë, duke siguruar prova me shkrim të ofertës, dhe ortakët e tjerë do të kenë 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës për të informuar ortakun shitës dhe ortakët e tjerë për vullnetin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Kur ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit kohor, do të thotë se kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes në favor të tyre.

Nëse një prej ortakëve të tjerë, që ofrohet për të blerë në parablerje për pjesën e tij kuotat e ortakut të shitjes, nuk synon të ushtrojë të drejtën e parablerjes, ortakët e tjerë të cilët kanë ushtruar tashmë për pjesën e tyre të drejtën e tyre të parablerjes mund të zgjerojnë këtë të drejtë për të gjitha ose një pjesë të kuotave të ofruara në parablerje për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes.

Në rast se më shumë ortakë dëshirojnë të zgjerojnë të drejtën e parablerjes, të ofruara për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes në mosmarrëveshje do të ndahet në pjesë të barabarta.

Në rastin kur vetëm njëri ortak dëshiron të zgjerojë të drejtën e tij të parablerjes, parablerjes në mosmarrëveshje ofruar për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, do të transferohet plotësisht në të gjitha ose pjesën që ai synon për të blerë.

Në këtë aspekt, anëtarët dëshirojnë të zgjerojnë të drejtën e tyre të parablerjes duhet të njoftojë ortakun shites, vendimin e tij brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e njoftimit të mungeses për të ushtruar të drejtën e parablerjes.

Të gjitha këto komunikime duhet të jenë me shkrim.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësajpike; dh)mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë sëveprimtarisë;
- ë) shpërndarjen e fitimeve vjetore
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Vendimet e shumicës të Asamblese janë detyruese për ortakë që mungojnë ose janë kundër, por kanë të drejtën e ankimit në rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja duhet të thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresen që rezulton në Librin e Ortakëve ose nepermjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtate) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përeaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit dhe specimentet e nenshkrimit (mbiemrat, emrat, adresat):

- Besnik Bahiti _____ me nr SIG H90517146B, Tirane.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asamblenja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asamblenja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asamblenja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrësolidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT KONTABËL

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe

mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët Kontabël

Nëse është e nevojshme apo të kërkohet nga ligji, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave të shoqërisë do t'i besohet një audituesi të autorizuar të emëruar në mënyrën e përcaktuar me ligj me të drejte riemërimi.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i regjistruar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Eksperti kontabel i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së njejtë të emerimit.

Neni 18

Fitimet

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, zbritur 5% (pese për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) të kapitalit themeltar, dhe gjithashtu të gjitha shumatat e tjera që Asambleja vendos t'i vëre menjëherë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara respektivisht.

Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të vecanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo edhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

Kreu V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 19

Prishja dhe Likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortakët merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 21

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet që mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

U lexua, u nenshkrua dhe u firmos.

ORTAKËT

SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Engjëll Dedja



Besnik Bahiti

